

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 834/2 Prot

Tiranë, më 3.04.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Nikoll DEDA

Adresa: "Rruga e Durrësit" Njësia Administrative, Nr.6 Tiranë
Nr. Tel: 0682063244

I nderuar Zoti Deda !

Agjencia e Mbrojtjes Policore, ka administruar ankesën Tuaj, Nr. N-6 Prot, datë 29.01.2026, nëpërmjet të cilës kërkon verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të punonjësve të policisë lidhur me prodhimin e një vule të re për Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Stomatologut.

Agjencia e Mbrojtjes Policore, për verifikimin e pretendimeve tuaj, kreu një hetimi të thelluar administrativ, rezultatet e të cilit ua bëjmë me dije si më poshtë:

I. Gjetjet mbi procedurën e prodhimit të vulës:

Nga dokumentacioni që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave) ka vënë në dispozicion të AMP-së, rezulton se:

Shtetasi Almiro Gurakuqi, në autoritetin e Presidentit Rajonal Tiranë të USSH dhe përfaqësues i Asamblesë Kombëtarë të USSH, me datë 09.04.2025, ka paraqitur kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Rendi, Sigurinë Publike dhe Çështjeve Territoriale në Ministrinë e Brendshme, për t'u pajisur me vule të re, për të garantuar vijimësinë e institucionit, duke renditur argumentat e mëposhtme:

- Ish-Presidenti i USSH (Z. Nikoll Deda) është pezulluar nga detyra me vendim gjykatë dhe se ndaj tij është caktuar masa e sigurimit (Arrest me burg);
- Zv/Presidentja e USSH, ka dhënë dorëheqje dhe është në ndjekje penale;
- Sekretari i Përgjithshëm i USSH është shkarkuar nga detyra;
- Zyra e Presidentit të USSH është e bllokuar dhe vula origjinale nuk gjendet.

Në praktikën dokumentare të procedurave të prodhimit të vulës së re, kopje e së cilës administrohet dhe nga ana jonë, bashkë me kërkesën për pajisje me vule të re të shtetasit Almiro Gurakuqi, përpiluar në cilësinë e Presidentit të Këshillit Rajonal Tiranë, ndodhen dhe dokumentat e mëposhtme:

- Vendim Nr.3 datë 15.04.2025 i Asamblesë Kombëtare të USSH;
- Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë Nr. 492, datë 22.02.2025 (vlerësuar nga DPPSH i barazvlefshëm me procesverbalin e asgjësimit të vulës së parë);
- Informacion/denoncimi, për humbje/mungesë e vulës origjinale të USSH që shtetasi Almiro Gurakuqi, ka "dërguar" në Komisarlatin e Policisë Nr.4, Tiranë.

Nisur nga sa sipër dhe bazuar në dokumentat e administruar si dhe verifikimet e kryera nga AMP, konstatohet se procedura e ndjekur nga strukturat e Policisë së Shtetit për prodhimin e vulës së re, nuk ka qenë në përputhje me dispozitat e VKM Nr.390, datë 06.08.1993 "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare" dhe Procedurës standarte të punës "Për marrjen, rregjistrimin, shpërndarjen, administrimin, përpunimin, arkivimin, ruajtjen e dokumentacionit si dhe të prodhimit të vulave zyrtare në DPPSH", miratuar me Udhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.1027, datë 11.07.2023,.

Për këtë arsye Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, me shkresën nr.N-6/3 datë 02.04.2026, i është drejtuar Drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke i kërkuar, analizimin e rastit me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive si dhe marrjen e masa për ndërperjen e paligjshmërisë dhe unifikimin e praktikave të kësaj natyre në vijimësi.

II. Qëndrimi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore mbi kompetencat dhe hapat e mëtejshëm:

Në lidhje me pretendimin tuaj, për heqjen e vulës nga qarkullimi, Ju sqarojmë se, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore nuk ka autoritet ligjor për të kryer këtë veprim dhe për këtë arsye i jemi drejtuar për marrje masash Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Të ndodhur në këto kushte, deri në marrjen e një vendimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe strukturat e varësisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ju sugjerojmë, që ju në cilësinë e përfaqësuesit ligjtim të Presidentit të USSH (Sipas vendimit Nr.1 datë 06.12.2025), duhet t'i drejtoheni organeve të ndjekjes penale, për veprimet e shtetasit Almiro Gurakuqi, pasi

përdorimi i vulës nga ana e tij pa pasur autoritetin ekzekutiv të përdorimit të saj, përmbajnë elementë të veprës penale "Përvetësim i titullit apo detyrës shtetërore", parashikuar nga neni 246 i K.Penal.

Për sa më sipër, Agjencia e Mbikëqyerjes Policore, mbetet e gatshme për bashkëpunim dhe ju fton të paraqisni çdo provë apo dokumentacion shtesë për çdo rast që lidhet me subjektet që mbikëqyren prej saj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe besimin ndaj Agjencisë,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Eduart MERKAJ

